

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIV, nr. 7839  
E premte, 19 korrik 2024  
Çmimi 0.50 €

## Qeveria rrit shtesat për fëmijët



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

# PSE GJITHË KJO ZHURMË RRETH LIGJIT PËR KËSHILLIN PROKURORIAL TË KOSOVËS?



Reagime pas miratimit të Ligjit të ri për Këshillin Prokurorial të Kosovës u bënë nga fronte të ndryshme ditët e

fundit. Miratimi i këtij ligji është pjesë e reformave, për të cilat është zotuar Ministria e Drejtësisë, prej që Lëvizja

Vetëvendosje ka ardhur në pushtet. Cilat janë ndryshimet kryesore që do t'i pësojë KPK-ja?

## KURTI: HAPJA E URËS SË IBRIT NUK ËSHTË KUNDËR ASKUJT



## PDK-JA FILLON TRI BETEJA TË REJA KUSHTETUESE



## AKTUALE



VON DER LEYEN RIZGJIDHET NË KRYE TË KOMISIONIT EVROPIAN F. 2

BIDENI INFEKTOHET ME KORONAVIRUS F. 2

AUTORITETET MAQEDONASE KONFIRMOJNË NDALIMIN E KOSOVARIT ME FLETARRESTIM NGA SERBIA F. 5

## EKONOMI



ODA EKONOMIKE AMERIKANE I BËN THIRRJE QEVERISË T'I ADRESOJË ÇËSHTJET NË DEKLARATËN PËR KLIMËN E INVESTIMEVE TË DASH-it F. 8

ATK-ja: 50 MILIONË EURO MË SHUMË TË HYRA TATIMORE NË GJASHTËMUJORIN E PARË F. 8

## SPORT



RANGLISTA E RE E FIFA-S, KOSOVA BIE PËR NJË POZITË, SHQIPËRIA NUK LËVIZ VENDI F. 10

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
MITROVICË  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjibiznesi.com](http://www.kolegjibiznesi.com)  
info@kolegjibiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVE  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Von der Leyen rizgjidhet në krye të Komisionit Evropian

STRASBURG, 18 KORRIK - Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, është zgjedhur edhe për një mandat në krye të këtij institucioni. Për t'i dhënë edhe një mandat pesëvjeçar von der Leyen votuan 401 eurodeputetë. Asaj i duheshin 360 vota nga 719 deputetë në Parlamentin Evropian. Ky institucion ka 720 ligjvënës, por një eurodeputet katalanas ende nuk ka marrë mandatin. Von der Leyen fitoi mandatin e dytë për 41 vota më shumë sesa kërkohen. Ky numër votash është më i lartë krahasuar më 2019, kur ajo fitoi vetëm 9 vota më shumë sesa kërkohen. Para votimit, von der Leyen i ka bërë publike prioritetet e saj për mandatin e ardhshëm, duke përfshirë edhe procesin e zgjerimit të bllokut evropian. "Kremtimi i 20-vjetorit të zgjerimit më të madh ndonjëherë të BE-së na mundësoi të reflektojmë mbi këtë proces, që u dëshmuoi si sukses për këto vende, dhe për BE-në në tërësi. Historia na thërret përsëri dhe BE-ja ka një

zgjedhje për ta bërë për të ardhmen e saj. Unë besoj se është një imperativ moral, politik dhe gjeo-strategjik që ta kompletojmë bllokun tonë, në përputhje me premtimet që kemi dhënë në bazë të traktateve", është thënë në deklaratën e shesheve të BE-së.

Ajo ka thënë se në një botë ku ekzistojnë fuqitë e mëdha, një BE më e fortë dhe më e zgjeruar, i jep Evropës një peshë më të madhe në skenën globale. Ajo ka përsëritur se procesi i zgjerimit do të mbetet i bazuar në meritat individuale të atyre që duan të bëhen pjesë e BE-së. "Ky nuk do të jetë një rrugëtim i lehtë. Anëtarësimi në BE do të jetë gjithmonë i bazuar në merita dhe secili kandidat do të vlerësohet në bazë të progresit në përmbushjen e kriterëve. Do t'i rrisim përpjekjet për t'i përgatitur vendet candidate, në veçanti përmes investimeve dhe reformave me planin e rritjes për Ballkanin Perëndimor, dhe mjetet për Ukrainën", ka thënë ajo.

Von der Leyen ka premtuar se pas



rizgjedhjes do ta emërojë një komisionar të përkushtuar për të çuar përpara procesin e zgjerimit. "Shumë kishin dyshime në aftësinë e BE-së për të integruar një numër të madh të vendeve të reja anëtare në vitin 2004, që kishin gjendje të

ndryshme ekonomike, strukturore dhe numër të banorëve. Por, BE-ja dëshmoi se mund të përballej me këtë, duke u përgatitur nga brenda, dhe duke i integruar shumë herët ato. Evropa do të dëshmojë këtë edhe një herë", ka thënë ajo duke folur

për zgjerimin.

Von der Leyen ka paralajmëruar edhe që do ta emërojë një komisionar të posaçëm për Mbrojtje dhe një tjetër për Mesdheun, pasi këto fusha, sipas saj, janë sfidë dhe prioritet për Bashkimin Evropian.

## Gjermania planifikon ta përgjysmojë ndihmën ushtarake për Ukrainën



BERLIN, 18 KORRIK - Gjermania është duke planifikuar që ta përgjysmojë ndihmën ushtarake për Ukrainën vitin e ardhshëm, prej rreth 8 miliardë eurove në rreth 4 miliardë, sipas një drafti të buxhetit të miratuar nga qeveria. Ministri i Financave, Christian Lindner, ka thënë se financat për Ukrainën "janë të sigurta për të ardhmen" për shkak të një skeme të grupit të shtatë shteteve më të industrializuara (G7) për të krijuar një fond prej 50 miliardë dollarëve prej interesit të marrë nga asetet e ngrira ruse.

Gjermania është e dyta - pas Shteteve të Bashkuara - për ndihmën ushtarake që i ka ofruar Ukrainës pas nisjes së pushtimit rus më 2022.

Më 2024 buxheti i Berlinit për Kievin është rreth 7.5 miliardë euro.

Ky shkurtim fondi është bërë në kohën e rritjes së shqetësimeve në Ukrainë, por edhe në mesin e aleatëve evropianë që Shtetet e Bashkuara mund ta ndalin tërësisht ndihmën, nëse kandidati i republikanëve, Donald Trump, fiton zgjedhjet

presidenciale të nëntorit.

Ndonëse ndihma ushtarake për Ukrainën pritet të zvogëlohet, buxheti i Gjermanisë për mbrojtje për vitin 2025 do të rritet për 1.3 miliardë euro në 53 miliardë euro.

Kështu, Gjermania pritet ta përmbushë targetin e kërkuar prej NATO-s, që vendet anëtare të shpenzojnë 2 për qind të bruto prodhimit të brendshëm në mbrojtje.

Tani, buxheti për mbrojtje do të duhet të miratohet nga ligjvënësit.

## Bideni infektohet me koronavirus

WASHINGTON, 18 KORRIK - Presidenti amerikan Joe Biden është infektuar me koronavirus dhe ka simptoma të lehta, ka njoftuar Shtëpia e Bardhë. Zëdhënësja e tij për media, Karine Jean-Pierre, ka thënë se presidenti amerikan është i vaksinuar dhe ka dozë përforcuese kundër virusit që shkakton sëmundjen Covid-19.

Bideni është infektuar edhe dy herë gjatë tjerë me këtë koronavirus në të kaluarën. Përmes një postimi në "X" Bideni i ka falënderuar të

gjithë për urimet për shërim të shpejtë, ndërsa ka thënë se do të vazhdojë të punojë për popullin amerikan.

Presidenti amerikan, 81-vjeçar, është parë të mërkurën duke vizituar mbështetësit në Llas Vegas dhe ka mbajtur një fjalim aty. Megjithatë, ai e ka anuluar një fjalim që ishte paraparë të mbahej më vonë në kuadër të fushatës presidenciale.

Infektimi i tij vjen në kohën kur Bideni po përballet me presion në rritje për të hequr dorë nga gara për një mandat të dytë presidencial për shkak

të moshës që ka.

Thirrjeve të 19 ligjvënësve demokratë për tërheqje të Bidenit nga gara për president i është shtuar të enjten edhe ligjvënësi nga Kalifornia, Adam Schiff, i cili po kandidon për Senatën amerikanë.

Shqetësimet e demokratëve mbi aftësitë e Bidenit për ta mposhtur rivalin republikan, Donald Trump, apo nëse është në gjendje ta udhëheqë vendin për një mandat të dytë, janë shtuar pas paraqitjes së dobët të tij në debatet e parë presidenciale, të mbajtur më 27 qershor.



## Kurti: Hapja e urës së Ibrit nuk është kundër askujt

PRISHTINË, 18 KORRIK - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë të enjten se qeveria e tij synon hapjen e urës kryesore mbi lumin Ibër dhe se ky veprim nuk është kundër askujt. Kurti i ka bërë këto deklarata një ditë pas takimit me ambasadorë të vendeve të Quintit në Kosovë dhe me shefin e zyrës së Bashkimit Evropian, me të cilët ka diskutuar për këtë çështje. Në Quint bëjnë pjesë Shtetet e Bashkuara, Mbretëria e Bashkuar, Gjermania, Franca dhe Italia. "Askush nuk mund të thotë që kjo nuk është një gjë e mirë dhe e drejtë, por ne dëshirojmë që edhe të zbatohet ligji, edhe të respektohet liria e lëvizjes, por edhe të kemi paqe dhe siguri për të gjithë", ka thënë Kurti në një konferencë për medie.

Ura kryesore mbi lumin Ibër që nga viti 1999 e ndan Mitrovicën në pjesën jugore, të banuar me shumicë shqiptare, dhe në pjesën veriore, të banuar me shumicë serbe. Vendimi për hapjen e urës është marrë në Kuvendin e Komunës së Mitrovicës së Veriut në prill të vitit 2023, por nuk është zbatuar ende. Sipas Kurtit, hapja e urës i ndihmon të gjithë banorët e asaj zone pa dallim etnie. "I ndihmon njerëzit në të dyja anët e Ibrit, edhe tregtinë, ekonominë, bashkëpunimin",

ka thënë ai.

Ai ka përmendur që para shumë vjetësh zyrtarë të Bashkimit Evropian i janë referuar hapjes së urës në tërësi për qarkullim si "simbol i normalizimit". "Kundër askujt, por për të gjithë", ka thënë Kurti kur e ka përmendur nevojën e hapjes së urës.

Diskutimet për urën janë aktualizuar në muajt e fundit, pas thirrjeve në Kuvendin Komunal të Mitrovicës së Veriut që ura të hapet tërësisht për qarkullim. Këtë komunë në veri të Kosovës e udhëheq Erden Atiq nga partia në pushtet, Lëvizja Vetëvendosje.

Kryetari i Kuvendit Komunal të Mitrovicës së Veriut, Nexhad Uglanin, pati thënë se zbatimi i vendimit për çështjen e urës u takon autoriteteve qendrore dhe institucioneve të sigurisë.

Zyrtarë të këtij Kuvendi madje patën thënë se hapja e urës është edhe nën juridiksion të Mitrovicës së Jugut dhe të misionit paqeruajtës të Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior (NATO) në Kosovë, KFOR.

Edhe zëvendës drejtori i Policisë së Kosovës për rajonin e veriut, Veton Elshani, pati paralajmëruar në maj se ura "do të hapet shpejt" dhe se po diskutohet me eprorët se si të bëhet kjo.

Faktori ndërkombëtar, në anën



tjetër, po kërkon vazhdimisht të ketë koordinim mes të gjitha palëve të prekura që të mos përshkallëzohet situata.

Karabinierët italianë të KFOR-it kanë prani të përhershme mbi urën e Ibrit dhe kryejnë patrullime në rrethinë. Ura

vëzhgohet edhe prej pjesëtarëve të Policisë së Kosovës.

Qeveria e Kosovës beson se liria e lëvizjes duhet të sigurohet në të gjithë territorin, por Serbia e konsideron hapjen e urës si "provokim".

Shqiptarët në Mitrovicë të Jugut

dhe serbët në Mitrovicë të Veriut, me të cilët ka biseduar më parë Radio Evropa e Lirë, janë të ndarë nëse ura duhet të hapet. Për shqiptarët hapja e urës do të ishte "gjë e mençur", ndërsa për serbët vendim që rrit tensionet.

## Qeveria rrit shtesat për fëmijët

PRISHTINË, 18 KORRIK - Qeveria e Kosovës të enjten ka njoftuar se ka rritur shtesat për fëmijët. Në një konferencë për medie rreth kësaj skeme të re folën kryeministri Albin Kurti dhe ministri i Financave, Hekuran Murati. Ata theksuan se me skemën e re për shtesat për fëmijët po e rrisin mbështetjen për nënat, kujdesin për fëmijët dhe mirëqenien për familjet.

Deri më tani shtesat kanë qenë 20 euro për fëmijët 0-2 vjeç dhe 10 euro për fëmijët 3-16 vjeç. Ndërsa sipas ministrit Murati, me skemën e re nuk ka më dallim 0-2 apo 3-16, por dallimi bëhet te numri i fëmijëve që familja ka.

Ai ka treguar se për familjen që ka vetëm një fëmijë të moshës 0-16 vjeç, familja merr shtesë prej 20 eurosh/muaj apo 240 euro/vit. Kurse për familjen që ka dy fëmijë të moshës 0-16 vjeç, familja merr shtesa 40 euro/muaj (2x20) apo 480 euro/vit, e për familjen që ka tre fëmijë të moshës 0-16 vjeç, familja merr shtesë 90 euro/muaj (3x30) apo 1 080.00 euro/vit. "Pra kapërcimi i madh bëhet te fëmija i tretë, i cili familjes ia shton 50 euro/muaj apo 600 euro/vit më shumë, sesa shuma e shtesave që familja merr kur ka dy fëmijë. Sepse nga shtesat 40



euro/muaj (480 euro/vit) për dy fëmijë, kalohet në 90 euro/muaj (1 080.00 euro/vit) për tre fëmijë. Edhe fëmijët e tjerë pas të tretit, shtesat do t'i kenë nga 30 euro secili", ka thënë ministri Murati.


Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve - KOMF

ka mirëpritur vendimin e ministrit të Financave për dyfishimin e shtesave për fëmijë, e cila është dokumentuar në shumë vende të botës si instrument efektiv në zbutjen e varfërisë së fëmijëve, parandalimin e uljes së natalitetit dhe rritjen e

mirëqenies së fëmijëve dhe familjeve. Me qëllim të krijimit të një skeme të shtesave për fëmijë gjithëpërfshirëse, efektive dhe të qëndrueshme, KOMF ka propozuar për rishikimin e skemës së shtesave për fëmijë me qëllim të përfshirjes së fëmijëve deri

në moshën 18-vjeçare. "Aktualisht kjo skemë nuk është gjithëpërfshirëse, pasi përfshin fëmijët deri në moshën 16-vjeçare.

Legjislacioni në Kosovë, por edhe Konventa për të Drejtat e Fëmijës, përcakton moshën e fëmijës deri në moshën 18-vjeçare. Përfshirja e fëmijëve deri në moshën 18-vjeçare është e nevojshme sidomos duke pasur parasysh faktin që aktualisht nuk ka ndonjë skemë të aplikueshme për mbështetjen e fëmijëve të moshës 16-18-vjeçare. Rritjen graduale të shtesave për fëmijë duke filluar nga viti i ri fiskal për ta siguruar mirëqenien e fëmijëve. Shuma aktuale e shtesave për fëmijë vazhdon të jetë e pamjaftueshme për t'i përmbushur nevojat e fëmijëve. Hartimin e bazës ligjore për shtesat për fëmijë për të siguruar qëndrueshmëri, duke qenë se aktualisht shtesat për fëmijë ofrohen në bazë të një vendimi. Krijimin e procedurave lehtësuese për aplikimin dhe përfitimin e shtesave për fëmijë për fëmijët pa kujdes prindëror. Aktualisht, fëmijët pa kujdes prindëror nuk gëzojnë këtë të drejtë dhe nuk përfitojnë nga shtesat për fëmijë", ka theksuar KOMF.



# Pse gjithë kjo zhurmë rreth Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës?

**Reagime pas miratimit të Ligjit të ri për Këshillin Prokurorial të Kosovës u bënë nga fronte të ndryshme ditët e fundit. Miratimi i këtij ligji është pjesë e reformave, për të cilat është zotuar Ministria e Drejtësisë, prej që Lëvizja Vetëvendosje ka ardhur në pushtet. Cilat janë ndryshimet kryesore që do t'i pësojë KPK-ja?**

**PRISHTINË, 18 KORRIK** - Reformat në Këshillin Prokurorial të Kosovës (KPK) janë të domosdoshme - për këtë pajtohen ekzekutivi, Komisioni i Venedikut, shoqëria civile, madje gatishmëri ka shprehur edhe vetë KPK-ja. Por, rreth jetësimit të këtij procesi është krijuar një çarje që gati dy vjet. KPK-ja është shtëpia e prokurorëve të Kosovës. Është organ i pavarur, me kompetenca të qarta në organizimin e sistemit prokurorial në Kosovë: i zhvillon të gjitha procedurat e emërimit të kandidatëve për prokurorë, bën vlerësimin e performancës së tyre dhe shqyrton masa disiplinore, ndër të tjera.

Më 11 korrik 2024 Kuvendi i Kosovës miratoi ndryshimet për plotësimin e ligjit të ri për KPK-në. Ligji u votua me shumicë të thjeshtë në mungesë të partive opozitare. Më 15 korrik KPK-ja e kritikoi ligjin, duke argumentuar se, me një veprim të tillë, pushteti synon ta bllokojë dhe ta bëjë jofunksional sistemin prokurorial, si dhe të ndërhyjë në gjithë sistemin e drejtësisë.

Të nesërmen Ministria e Drejtësisë (MD) tha se reagimi i KPK-së ishte vazhdimësi "e qasjes destruktive, e veprimeve penguese dhe e tendencave të vazhdueshme bllokuese".

Në pasditen e 18 korrikut, Partia Demokratike e Kosovës, parti në opozitë, e dërgoi Ligjin e miratuar në Gjykatën Kushtetuese.

Pjesëtarë të shoqërisë civile i shohin këto përplasje si një tjetër episod të keqkomunikimit ndërmjet të dyja palëve dhe vlerësojnë se në këtë mes kanë ndikuar kritikën e vazhdueshme publike që i janë bërë KPK-së nga MD-ja.

## Rruga deri te miratimi

Me ardhjen e Lëvizjes Vetëvendosje në pushtet më 2021, MD-ja u zotua për reforma në sistemin gjyqësor. Ndryshimet në KPK i pa të arsyeshme për t'i balancuar anëtarët e saj. Edhe Komisioni i Venedikut, organ këshillues i Këshillit të Evropës, vlerësoi që "çdo shtet duhet ta gjejë formulën për të

krijuar një këshill pluralist prokurorial".

Aktualisht KPK-ja përbëhet nga 13 anëtarë: 10 prokurorë dhe tre anëtarë joprokurorë.

Në hartim e sipër të ndryshimeve u propozua rritja e numrit të anëtarëve në 19, përfshirja e Avokatit të Popullit në emërimin e anëtarëve joprokurorë, shkurtimi i mandatit të anëtarëve aktualë, si dhe forcimi i rolit të anëtarëve joprokurorë për t'u dhënë deri diku aftësi vendimmarrëse. Kjo u pa si tendencë e pushtetit për politizim të sistemit, ndërsa pothuajse të gjitha pikat ranë ndesh me dy opinione të Komisionit të Venedikut, të publikuara më 2022 dhe më 2023.

Deputetë opozitarë e dërguan projektligjin për KPK-në në Gjykatën Kushtetuese, e cila, gjithashtu, vlerësoi se një pjesë e konsiderueshme e ndryshimeve nuk ishin në përputhje me Kushtetutën.

## Çfarë parasheh ligji i ri i miratuar?

Pas ndryshimeve të bëra, ligji i ri parasheh që KPK-ja të përbëhet nga shtatë anëtarë - kryeprokurori, sipas detyrës zyrtare, tre prokurorë dhe tre anëtarë joprokurorë - me mandat pesëvjeçar.

Ndryshimi tjetër është që anëtarët joprokurorë nuk do të propozohen më nga shoqëria civile apo institucione specifike, por do të hapet konkurs publik nga Kuvendi i

Kosovës. Më pas, kandidatët potencialë do të vlerësohen prej një komisioni të pavarur para se për ta të votohet në Kuvendin e Kosovës, ku emrat e tyre do të miratohen me shumicë të thjeshtë.

Shumica e këtyre dispozitave do të hyjnë në fuqi në janar të vitit 2026, pasi atëherë u skadon mandati disa prej anëtarëve aktualë të KPK-së. Vullnet Bugaqku, hulumtues i lartë në Institutin Demokratik të Kosovës (KDI), thotë për Radion Evropa e Lirë se beson që pjesa më e madhe e rekomandimeve të Komisionit të Venedikut janë marrë parasys, ashtu sikurse vendimi i Kushtetueses.

Ai e konsideron shumë të rëndësishme edhe përfshirjen e atij që e quan mekanizëm të zhbllokimit. "Kur anëtarët joprokurorë ose anëtarët e tjerë të KPK-së mund t'i sabotojnë me qëllim takimet, përpos që duhet të merren masa disiplinore ndaj tyre, Komisioni i Venedikut ka paraparë që të bëhet një mekanizëm i zhbllokimit, ashtu që kuorumi të mos jetë me pesë, por me shumicë të thjeshtë votash".

Këtë pikë KPK-ja e interpreton ndryshe. Pse?

## Mospajtimet për kuorumin

Duke insistuar që kuorumi mund të arrihet vetëm me pesë anëtarë, kryesuesi i KPK-së, Ardian Hajdaraj, thotë për Radion Evropa e Lirë se

vendimmarrja dhe kuorumi nuk duhet të varen prej anëtarëve joprokurorë, andaj ka kërkuar që në përbërje të anëtarëve të jenë pesë prokurorë dhe dy anëtarë joprokurorë. "Me ligjin e ri është propozuar që të bëhet kontrolli i KPK-së përmes të zgjedhurve nga organet politike", pohon Hajdaraj, duke iu referuar anëtarëve joprokurorë.

Por, sipas ligjit, në rastet e mospjesëmarrjes së vazhdueshme të disa anëtarëve, kuorumi mund të formohet me së paku katër anëtarë të KPK-së, dhe ata mund të marrin vendime. Aty përmendet se vendimet e KPK-së merren me shumicë të thjeshtë votash, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj.

Bugaqku, i cili ka marrë pjesë në grupet punuese për ligjin, vlerëson se kuorumi me pesë anëtarë është i detyrueshëm vetëm në raste specifike, sikurse emërimi i kandidatit për kryeprokuror të Shtetit, apo vendime të tjera madhore. Shefi i Zyrës së Bashkimit Evropian (BE) në Kosovë, Tomas Szunyog, ka thënë se Kuvendi ka dështuar t'i inkorporojë të gjitha rekomandimet për ta bërë një ligj të mirë për KPK-në.

Ndërkaq ambasadori amerikan në Kosovë, Jeffrey Hovenier, ka thënë se ka biseduar me disa zyrtarë të pushtetit për këtë ligj, dhe se i ka porositur ata të sigurohen secilën herë që legjislacioni i miratuar të jetë në përputhje me normat evropiane.

# PDK-ja fillon tri beteja të reja kushtetuese

EPOKA  
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 18 KORRIK - Grupi parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës të enjten ka dorëzuar në Gjykatën Kushtetuese tri kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit për Komisionin e Pavarur të Medieve (KPM), atij për Këshillin Prokurorial të Kosovës (KPK), si dhe për vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimit për ndryshimin e Statutit të Universitetit të Prishtinës "Hasan

Prishtina", akte të cilat janë miratuar në seancën e fundit të Kuvendit të Kosovës.

Kryetari i grupit parlamentar të PDK-së, Abelard Tahiri, tha se përmes kontestimit të Ligjit për KPM-në është sfiduar tendenca e pushtetit për t'i kontrolluar mediet e lira dhe të pavarura dhe për t'i shkelur parimet e lirisë së medias dhe lirisë së shprehjes, si vlera themelore të rendit kushtetues. "Madje kjo ka shkuar aq larg sa që përmes këtij projektligji tentohet të kontrollohen edhe personat fizikë

të cilët prodhojnë kontent dhe mund t'i shpërndajnë qoftë përmes medieve, qoftë përmes rrjeteve sociale", theksoi Tahiri. PDK-ja konsideron që përmes Ligjit për KPK-në shkelen garancitë kushtetuese si prezumimi i pafajësisë dhe i sigurisë juridike, në kuptimin e vendosjes së standardeve të ndryshme për emërimin e anëtarëve të KPK-së në raport me standardet e ndryshme për shkarkimin e tyre. "Konsiderojmë që përmes këtij projektligji pushteti aktual po synon ta kapë

sistemin prokurorial, rrjedhimisht organin e akuzës që ka për detyrë luftimin e krimit të organizuar, korrupsionit dhe dukurive të tjera negative në vendin tonë", tha ai. Sa i përket vendimit për Statutin e UP-së, Tahiri tha se përmes tij synohet cenimi i marrëdhënies së punës së stafit akademik të UP-së, duke i vendosur të njëjtit përballë situatave të presioneve dhe kërcënimeve të pabaza për humbjen e titujve akademikë e, për rrjedhojë, edhe të marrëdhënies së punës. GP i PDK-së, ashtu siç ka bërë

deri më tani, edhe në këtë rast i ka qëndruar besnik Kushtetutës dhe mbrojtjes së saj dhe është besimplotë se edhe këto raste do të konfirmohen si shkelje kushtetuese dhe në këtë mënyrë do të evitohen pasojat e pariparueshme që këto akte do t'u shkaktonin institucioneve të pavarura kushtetuese, por edhe të drejtave dhe lirive të njeriut. "Këto janë nisma në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe jemi të bindur që do të dalim fitues", përfundoi Tahiri.



## Autoritetet maqedonase konfirmojnë ndalimin e kosovarit me fletarrestim nga Serbia

SHKUP, 18 KORRIK - Ministria e Punëve të Brendshme e Maqedonisë së Veriut ka konfirmuar se më 17 korrik është arrestuar një shtetas i Kosovës, bazuar në një fletarrestim të lëshuar nga Serbia. "Me datë 17.07.2024, në orën 16:00, në vendkalimin kufitar Jazhincë, me të hyrë në shtet, zyrtarët policorë e kanë ndaluar B. R. (47-vjeçar) nga Kosova, pasi gjatë kontrollit të pasaportave është konstatuar se ai ishte i regjistruar me 'Apsi' me kërkesë të Serbisë dhe ai u është dorëzuar autoriteteve në Tetovë për veprime të mëtutjeshme", tha Ministria e Punëve të Brendshme e Maqedonisë së Veriut.

Lajmi për ndalimin e shtetasit nga Kosova është dhënë fillimisht nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës e Kosovës. "Fjala është për zotin Blerim Ramadani, ish-anëtar i Zonës Operative të Nerodimes të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës", tha MPJD-ja.

Arrestimi u krye në pikëkalimin kufitar Jaznicë - Gllboqicë, që



lidh Kosovën me Maqedoninë e Veriut.

MPJD tha se ambasadori i Kosovës në Maqedoninë e Veriut është duke u angazhuar në këtë rast dhe autoritetet po punojnë për ta siguruar lirinë e shpejtë të Blerim Ramadani. Së fundi,

autoritetet në Serbi kanë arrestuar edhe katër shtetas të Kosovës të cilët Beogradi i ka akuzuar për krime lufte. Autoritetet e Kosovës e kanë cilësuar arbitrar dhe të padrejtë arrestimin në Serbi të qytetarëve të Kosovës për këto akuza dhe

kanë kërkuar ndihmën e faktorit ndërkombëtar për lirinë e tyre. Në fillim të korrikut ministria e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, përmes një letre dërguar homologes serbe, kërkoi transferimin e shtetasve të Kosovës që po mbahen në Serbi.

Megjithatë, Haxhiu deklaroi se vështirë se Serbia do t'i përgjigjet kërkesës së autoriteteve të Kosovës për ekstradimin e shtetasve të Kosovës për shkak të mosbashkëpunimit të vazhdueshëm juridik.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka deklaruar se shteti i tij ka juridiksion të njohur ndërkombëtarisht mbi trajtimin e veprave që kryhen brenda territorit të saj.

Serbia, në strategjinë e vet kombëtare 2021-2026 për ndjekje të krimeve të luftës, pretendon se ka juridiksion për të vënë drejtësi për krimet e kryera gjatë konflikteve të armatosura në vitet '90.

Kosova dhe Serbia arritën Marrëveshje për Ndihmë të Ndërsjellë Juridike më 2013 me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian, por bashkëpunim mes tyre për rastet e krimeve të luftës nuk ka pasur pothuajse fare. Ndërkaq, Shtetet e Bashkuara kanë bërë thirrje për proces të drejtë ligjor për personat e arrestuar në Serbi me akuza për krime lufte.

# Turizmi dhe bashkëpunimi ekonomik Kosovë - Shqipëri mos të varet nga raportet dhe inatet personale Rama - Kurti



Shkruan: Safet GËRXHALIU,  
ish-kryetar i Odës  
Ekonomike të Kosovës

Jemi dëshmitarë se raportet personale dhe partneriteti mes kryeministrit të Shqipërisë, Edi Ram dhe kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti nuk janë në nivelin e duhur si dy liderë të dy shteteve të një populli të ndarë.

Këto tensione politike dhe mesazhet e përçara të liderëve kanë krijuar një ndjenjë të distancës mes dy popujve, të cilët ndajnë të njëjtën gjuhë, kulturë dhe histori.

Raportet ekonomike nuk janë në nivelin e duhur të bashkëpunimit, ku eksporti dhe importi në mes të Kosovës dhe Shqipërisë në rrethana normale ishte dashur të ishte në mes të dy firmave biznesore e jo në mes të dy shteteve.

Janë organizuar takime ndërqeveritare në mes të Kosovës

dhe Shqipërisë, përmes së cilave janë nënshkruar shumë marrëveshje të bashkëpunimit, por efektet e implementimit nuk kanë dhënë rezultatet e pritura. Nga Kosova në Shqipëri dhe anasjelltas lajmi i mirë nuk është lajm. Vetëm lajmi i keq mirëpritet dhe promovohet.

Është aktualizuar debati për turizmin ku një numër i konsiderueshëm i kosovarëve nuk i kalojnë pushimet verore në Shqipëri, ndryshe nga vitet e kaluara kur bregdeti shqiptar ishte destinacioni kryesor për kosovarët. Ky debat sa tendencioz po aq i politizuar shumë më tepër po i dëmton këto raporte se sa që po i përmirëson ato.

Kriza ekonomike në Kosovë është e evidente dhe me këtë po ballafaqohen qytetarët dhe biznesi, por jo politika dhe institucionet vendore.

Varfëria dhe inflacioni i lartë kanë bërë që shumë qytetarë të hyjnë në kredi për të financuar pushimet verore.

Sipas statistikave të bankave dhe institucioneve mikrofinanciare, shumica e qytetarëve po përballen me vështirësi ekonomike.

Inflacioni dhe çmimet e larta të produkteve elementare dhe

mosrritja e pagave kanë bërë që rreth 50% e popullsisë as të mos mendojnë për pushime verore gjë që nuk ka ndodhur në të kaluarën. Liberalizimi i vizave për qytetarët e Kosovës ishte i vonuar dhe i padrejtë. Nga fillimi i vitit 2024 filloi lëvizja e lirë dhe ky proces ka hapur dyer dhe horizonte të reja për kosovarët që të vizitojnë vende të ndryshme evropiane.

Shumë qytetarë kanë preferuar të eksplorojnë destinacione si Greqia, Kroacia, Spanja dhe vende të tjera tërheqëse. Një pjesë e tyre kanë zgjedhur të bashkohen me të afërmit që jetojnë jashtë vendit dhe të kalojnë pushimet në një mjedis familjar. Gjithashtu, liberalizimi i vizave ka ofruar mundësi për shumë kosovarë që të kërkojnë punë sezonale në vendet evropiane, duke e shfrytëzuar periudhën prej tre muajsh të lejuar për qëndrim.

Agjencitë turistike të vendeve si Greqia, Turqia, Spanja, dhe Kroacia kanë zhvilluar fushata të fuqishme marketingu për të tërhequr turistë nga Kosova. Ofertat e tyre të volitshme dhe shërbimet cilësore kanë bërë që shumë kosovarë të preferojnë këto destinacione për pushimet e tyre. Fushatat e tyre kanë ekspozuar manipulimet me

çmimet që janë bërë nga disa agjenci dhe hotele në Shqipëri, duke ofruar një alternativë më tërheqëse dhe me çmime më reale për turistët.

Një tjetër aspekt që duhet të theksohet është trajtimi i turistëve kosovarë në Shqipëri. Shumë prej tyre janë ankuar për çmime të larta dhe për një shërbim jo të duhur. Për të përmirësuar situatën dhe për të tërhequr më shumë turistë nga Kosova, është e nevojshme që Shqipëria të ofrojë çmime më reale dhe një trajtim më të mirë për turistët kosovarë. Kjo do të ndihmonte në rikthimin e besimit dhe në përmirësimin e marrëdhënieve turistike mes dy vendeve.

Shqipëria ka qenë, është dhe do të jetë destinacion për kosovarët, por kalimi i shpejt nga turizmi masiv në atë elitë mund të lë edhe efekte negative.

Marrëdhëniet personale dhe politike në mes të liderëve të Shqipërisë dhe Kosovës nuk duhet të ndikojnë në turizmin dhe në ndjenjën e afërsisë mes dy popujve.

Kriza ekonomike dhe preferencat e reja të kosovarëve për destinacione të tjera, së bashku me fushatat e fuqishme të marketingut të vendeve të tjera,

kanë ndikuar në zgjedhjet e tyre për pushimet verore.

Tentativa për të politizuar turizmin është dëmi më i madh që mund t'i bëhet nga kudo që vjen. Bukurit natyrore të Shqipërisë janë dhe do të mbeten ndër mote, e politika dhe inatet personale janë kalimtare.

Është koha që në Shqipëri të kuptohet rëndësia e çdo turisti dhe tyre nuk duhet qasje selektive apo fragmentuese por të barabartë dhe njerëzore.

Eurot e fituara nga turizmi janë të njëjta qoftë të ardhura nga një gjermanë, italianë, serbë apo kosovarë.

Më e mira që ka ndodhur në raportet gjithëpërfshirëse në mes të Kosovës dhe Shqipërisë është fati që qytetarët dhe bizneset kanë bërë shumë hapa të avancuar në bashkëpunim se sa politika.

Nuk ka vend për panik sepse kosovarët janë besnik dhe falënderues ndaj Shqipërisë.

Kanë qenë, janë dhe do të mbeten ambasadorë të bukurive natyrore të Shqipërisë, por duhet të kuptohet se për luftë dhe dashuri duhen gjithëherë dy palë.

Le të vazhdojë debati e le të flitet, por le të kuptohet se ku është Kosova është edhe Shqipëria e anasjelltas.



## Rreth 40 gra promovojnë punimet e tyre në panairin "Gratë në biznes"

PRISHTINË, 18 KORRIK - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) ka organizuar panairin "Gratë në biznes", në të cilin kanë marrë pjesë të cilin kanë marrë pjesë biznese dhe shoqata të grave ndërmarrëse nga komunitetet të ndryshme të Kosovës.

Përveç promovimit të bizneseve dhe shoqatave të udhëhequra nga gratë dhe produkteve që këto biznese ofrojnë në fushat e tyre përkatëse, ky panair ka për qëllim edhe inkurajimin e ndërmarrësisë dhe rrjetëzimin te gratë ndërmarrëse me qëllim të fuqizimit sa më të madh të tyre në shoqëri dhe në biznes.

Ministrja e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Rozeta Hajdari, ka thënë se në këtë panair janë duke marrë pjesë 40 gra. Ajo ka theksuar se synimi i MINT-it është që të rritet sa më shumë numri i grave që regjistrojnë biznese në emër të tyre, ku theksoi se kanë lehtësuar edhe më shumë regjistrimin e biznesit.



# Hoxhaj: Ftesa për Osmanin në Londër tregon se Kurti është i izoluar nga të gjitha ngjarjet e mëdha ndërkombëtare

PRISHTINË, 18 KORRIK - Të enjten në Londër ka nisur Samiti i Komunitetit Politik Evropian në Londër, që organizohet nga kryeministri Starmer. Aty do të takohen kryeministrat dhe nga Kosova është ftuar presidentja Vjosa Osmani, por jo kryeministri Albin Kurti.

Ish-ministri i Punëve të Jashtme, Enver Hoxhaj, ka thënë se kjo tregon se Kurti është gjithnjë e më i izoluar në të gjitha ngjarjet e mëdha ndërkombëtare. "Javën e kaluar nuk u ftua as në përvjetorin e 75 të themelimit të NATO-s në ShBA, ku 25-vjetori i çlirimit është ndër sukseset më të mëdha të NATO-s në historinë e saj dhe siguria në një botë të pasigurt është prioritet i çdo shteti, dhe Kosova nuk ka qenë asnjëherë më shumë e kërcënuar se tani! Këtë javë nuk udhëton as për në Londër, meqë nuk është ftuar as në Britani të Madhe. Sot kuptova se, meqë Bashkimi Evropian e bën protokollin e



ftesave për këtë Samit, janë evropianët ata që nuk e duan Kurtin në Samit. Duhet të jesh i marrë e të besosh se BE shqyrton

aplikacionin e një vendi për të marr statusin e kandidatit në BE, apo që evropianët të mbështesin anëtarësimin e Kosovës në

Këshill të Evropës, kur as nuk e ftojnë fare kryeministrin me një Samit joformal, por të rëndësishëm gjeopolitik, ku do

jenë shumë kryeministra të BE dhe jashtë saj!", ka thënë Hoxhaj. Ai ka theksuar se ftesa i ka ardhur Osmanit, por nga përvoja e tij e gjatë në qeveri, natyrisht ajo ka mundur ta delegojë ftesën te kryeministri. "Delegimi i ftesave bëhet shpesh në çdo shtet dhe e kemi bërë shpesh në Kosovë. Mirëpo, as ajo nuk po i jep hapësirë askund Kurtit, duke e bërë atë të izoluar jo vetëm në botë, por edhe në Kosovë! Janë bërë më shumë se një muaj që kur përfaqësuesi i lartë i BE-së Josep Borell ia dorëzoi Këshillit Evropian raportin për heqjen e masave ndaj Kosovës, dhe ende nuk ka një vendim të vendeve anëtare për këtë çështje dhe as që dikush mendon që kjo duhet të ndodhë! E sanksionuar dhe e izoluar, sot Kosova është një demokraci pa opsione të zgjedhjes, një sovranitet i pa kuptim dhe një vend pa kurrfarë kredibiliteti ndërkombëtar", ka thënë Hoxhaj.

## Deputetja e LDK-së thotë se skema e shtesave për fëmijë është blerje e votave nga qeveria Kurti

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 18 KORRIK - Deputetja e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Hykmete Bajrami, ka thënë se rritja e shtesave për fëmijë nga qeveria Kurti është bërë në këmbim të votës së qytetarëve. Ajo ka thënë se qytetarët nuk janë brengë për qeverinë Kurti, por vota e tyre. "Sot, në emër të mirëqenies së fëmijëve, qeveria e dështimeve dhe e korrupsionit filloi zyrtarisht fushatën me 'skema për blerje të votave'. Në këmbim të votës së tyre iu kthehet qytetarëve vetëm një pjesë e asaj çfarë qeveria ka marrë nga ata që tri vite e gjysmë si pasojë e çmimeve më të larta. Mos u mashtronit! Në ditët dhe javët në fillim skema të tilla do të vazhdojnë, pasi jemi në kohë fushate, e qeveria ka dështuar të përmbush 10% të asaj çka ka premtuar, tani me paratë që ka

plaçkitur nga ju si rezultat i tatimeve më të larta si pasojë e inflacionit, do të tentojë të blejë vota edhe për një mandat", ka shkruar Bajrami në "Facebook". Ajo ka thënë se këto skema duhet të kuptohen drejt. "Nuk pa lansohen se qeveria brengoset për qytetarët, sepse sikur qytetarët të ishin brenga e kësaj qeverie shtesat, pagat dhe pensionet do të rriteshin në vitin 2022 kur inflacioni ishte dyshifror. Nuk u rriten atëherë edhe pse Lidhja Demokratike e Kosovës insistoj, por u rriten sot, sepse nuk jeni ju brenga e Albin Kurtit, vota e juaj është", ka thënë deputetja Bajrami. Sipas saj, LV-ja ka ardhur në pushtet jo vetëm me premtimin e shtesave për fëmijë, por me shumë premtime. "Lirimim e çmimit të energjisë, premtimin që buka, vaji, sheqeri me qeverisjen e tyre do të kushtojë më lirë. Kanë premtuar sigurime shëndetësore, arsim, drejtësi,

punësim, kthim të trurit, ndërtimin e 160 çerdheve, 4000 banesave për të rinjtë, ndërtimin e pesë shtëpive për të moshuarit, ndërtim të rrugëve, urave, tuneleve e magjistrave, integritet euroatlantike dhe anëtarësim në organizata ndërkombëtare. Por krejt çka ka ndodhur këto tri vjet e gjysmë të mandatit të tyre është e kundërta, fiks e kundërta. Çerdhet nuk janë ndërtuar, as shtëpitë për të moshuarit dhe as banesat për qiftet e reja. Çmimi i rrymës është dyfishuar, njëjtë si çmimet e artikujve ushqimor. Si pasojë sot ka më shumë qytetarë të varfër, dhe cilësia e jetës ka pësuar rënie për secilën familje. Deri më sot nuk është përfunduar asnjë projekt infrastrukturor, as ato që në fillim të mandatit të tyre kanë qenë në gjysmë", ka thënë ajo. Deputetja Bajrami ka thënë se ka ikje masive të fuqisë punëtore dhe, sipas saj, është shkelur



Kushtetuta plot 10 herë, ndërsa arsimit po rënohet. "Që tri vite asnjëherë viti shkollor nuk ka filluar me kohë, janë humbur qindra mijëra orë mësim, nuk ka integritet euroatlantike dhe që 13 muaj jemi nën sanksione të BE-së. Asnjë njohje, asnjë anëtarësim, ka korrupsion dhe nepotizëm si asnjëherë më parë" është

shprehur Bajrami, duke shtuar se tani krejt këto dështime kryepopullisti, duke iu referuar Kurtit, po mundohet t'i mbulojë me, kinse, kthimin e një pjese të parave që ka marrë nga qytetarët që tri vite e gjysmë, e të cilat ka dështuar t'i kthejë në shërbime, mallra, projekte infrastrukturore e rritje të mirëqenies.

## Konjufca vlerëson rolin e madh që UNICEF-i ka luajtur ndër vite në Kosovë



PRISHTINË, 18 KORRIK - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka pritur të enjten në takim drejtoreshën e re të Zyrës së UNICEF-it në Kosovë, Veronika Vashchenko. Konjufca e falënderoi Vashchenkon për vizitën dhe e uroi atë për detyrën e re, duke i dëshiruar një mandat sa më të frytshëm dhe duke i shprehur gatishmërinë e plotë për të ruajtur dhe zhvilluar edhe më tej bashkëpunimin institucional. Po ashtu, kryetari Konjufca

vuri në dukje rolin e madh që UNICEF-i ka luajtur ndër vite në Republikën e Kosovës, për t'i mbrojtur të drejtat e të rinjve dhe fëmijëve, si dhe u shpreh i bindur se së bashku me institucionet e vendit tonë, duke përfshirë edhe Kuvendin e Republikës së Kosovës, do të vijohet të punohet me angazhim të plotë në drejtim të mbrojtjes dhe zhvillimit të potencialit të kësaj kategorie jashtë mase të rëndësishme. Drejtoresha e Zyrës së UNICEF-it në Kosovë, Veronika Vashchenko, e

falënderoi kryetarin Konjufca për pritjen dhe për gatishmërinë e treguar për të arritur sa më shumë në drejtim të mbrojtjes së të drejtave dhe zhvillimit të kapaciteteve që ndërlidhen me të rinjtë dhe fëmijët në Republikën e Kosovës. Ajo u shpreh e bindur se përmes programeve të UNICEF-it dhe bashkëpunimit me institucionet e vendit tonë do të ketë gjithnjë e më shumë përparim dhe arritje të këtyre qëllimeve që përbëjnë interes të përbashkët.

# Oda Ekonomike Amerikane i bën thirrje qeverisë t'i adresojë çështjet në Deklaratën për Klimën e Investimeve të DASH-it

**EPOKA E RE** **Faton DËRMAKU**

**PRISHTINË, 18 KORRIK** - Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë ka shprehur vlerësimin e saj pozitiv lidhur me konfirmimin së fundmi të kushtetueshmërisë së Ligjit për Investimet e Qëndrueshme.

OEAK thekson se ky akt legjislativ, së bashku me përpjekjet e tjera për thjeshtimin e procedurave të regjistrimit dhe reduktimit të ngarkesave burokratike, do të duhej të ndikonte në lehtësinë e të bërit biznes në vend. "Megjithatë, ndërhyrjet politike në ekonomi, politikat tekanjoze ekonomike dhe dialogu i kufizuar publiko-privat lënë në hije përpjekjet e kufizuara reformuese, ashtu siç ceket edhe në Deklaratën e Klimës së Investimeve të Departamentit Amerikan të Shtetit për Kosovën. Prandaj, Oda Amerikane përsërit thirrjen e saj për shmangie të ndërhyrjeve arbitrare të pushtetit, me qëllim të respektimit të parimeve të sundimit të ligjit dhe promovimit të lirive ekonomike, e kjo duhet ta përfshijë edhe shmangien nga sulmet verbale ndaj institucioneve të drejtësisë. Sulmet si këto, të bëra edhe ndaj Gjykatës Komerciale, e themeluar dhe fuqizuar edhe me ndihmën e Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, pashmangshëm ndikojnë në aftësinë e institucioneve të drejtësisë për ta



kryer punën e tyre në mënyrë të pavarur dhe objektive. Veprimet e tilla, por edhe masat ndëshkimore ndaj disa përbaruesve privatë, minojnë përpjekjet e gjithmbarshme për rritjen e sigurisë juridike, rrjedhimisht edhe tërheqjen e investimeve të huaja në asete produktive", thuhet në reagim.

"Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë shpreh shqetësimin e saj edhe me vazhdimin e masave që ndalojnë importet e produkteve finale nga Serbia, për aq kohë sa lëndët e para dhe materialet gjysmë të gatshme lejohen të

importohen pa pengesë, në kundërshtim me frymën e promovimit të lëvizjes së lirë të mallrave ndërmjet shteteve të Ballkanit Perëndimor si dhe në kundërshtim me zotimet që Kosova ka pranuar në rrugën e saj integruese në Bashkimin Evropian.

Ashtu siç ceket në Deklaratën e Klimës së Investimeve të Departamentit të Shtetit, ndalesa e importit ka ndikuar negativisht në kompanitë që janë në pronësi të huaj dhe ashtu siç është thënë në mënyrë të përsëritur nga Oda Amerikane se ndalesa e tillë godet

direkt interesat komerciale të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, si dhe shteteve të tjera partnere brenda Bashkimit Evropian. Barrierat e tilla çregullojnë zinxhirët e furnizimit, trazojnë tregjet dhe kanë ndikim te konsumatori fundor", thuhet tutje në deklaratë.

Oda Amerikane dëshiron të theksojë se dokumentet si ky i Departamenti të Shtetit janë me peshë gjatë marrjes së vendimeve nga ana e investitorëve seriozë amerikanë dhe investitorëve të tjerë të jashtëm. Edhe shqetësimet lidhur me tentimet e

revokimit arbitrar të certifikatave të biznesit të disa ndërmarrjeve janë serioze dhe si të tilla edhe dëshmi të lehtësisë së të bërit biznes në vend. "Oda Amerikane beson fuqishëm se çështjet si këto duhet të jenë subjekt i vendosjes së institucioneve gjyqësore, e verdiktet e tyre nuk mund të konsiderohen të drejta, për aq kohë sa mbi to ushtrohet presion nga ana e drejtuesve më të lartë të pushtetit ekzekutiv e legjislativ, si cenim i parimit demokratik të ndarjes së pushteteve.

Oda Amerikane thekson edhe renditjen shqetësuese të Kosovës në Indeksin e Lirive Ekonomike të organizatës Heritage Foundation në tri vitet e fundit, si vend me liri mesatare ekonomike, respektivisht i 37-ti në mesin e 44 shteteve të Evropës, me 60.6 pikë në vitin 2024 kundrejt 67.9 në vitin 2017.

Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë i bën thirrje Qeverisë së Republikës së Kosovës t'i adresojë me prioritet shqetësimet e sipërcekura që burojnë nga Deklarata e Klimës së Investimeve e Departamentit të Shtetit Amerikan, përfshirë edhe çështjet strukturore të cilat pengojnë rritjen ekonomike dhe produktivitetin, ndërsa dialogu dinamik dhe i sinqertë me sektorin privat është imperativ për arritjen e këtyre synimeve", thuhet në deklaratën e OEAK-ut.

## ATK-ja: 50 milionë euro më shumë të hyra tatimore në gjashtëmuajorin e parë

**PRISHTINË, 18 KORRIK** - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ka paraqitur rezultatet dhe të arriturat për gjashtë muajt e parë të vitit 2024.

Drejtori i përgjithshëm i ATK-së, Ilir Murtezaj, gjatë kësaj konference për medie ka folur për treguesit kryesorë të mbledhjes së të ardhurave, efikasitetin e shërbimeve dhe progresin për përbushjen e objektivave strategjike.

Murtezaj ka thënë se ATK-ja ka arritur rezultate mbresëlënëse në mbledhjen e të hyrave gjatë periudhës janar - qershor 2024, duke theksuar se të hyrat e mbledhura kanë tejkaluar pritshmëritë, duke arritur në 473.3 milionë euro, që tregon rritje prej 50.1 milionë eurosh më shumë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

"Ky sukses i atribuohet përmirësimit të proceseve të mbledhjes dhe angazhimit të shtuar të tatimpaguesve në përbushjen e obligimeve të tyre. Gjatë kësaj periudhe ATK-ja ka zbatuar 15 442 aktivitete intensive për parandalimin e evazionit tatimor dhe edukimit tatimor. Këto aktivitete kanë ndihmuar në rritjen e ndërgjegjësimit të obligimeve tatimore, duke

kontribuar në përmirësimin e pajtueshmërisë dhe uljen e evazionit fiskal. Këto aktivitete kanë rezultuar me 1.5 milion euro gjoba, 43.8 milionë euro tatim shtesë, 9.8 milionë euro janë konstatuar mungesë në stoqe, si dhe 3 809 punëtorë janë formalizuar si të punësuar", ka thënë ai.

Sipas tij, një ndër arritjet kryesore të ATK-së ka qenë avancimi i proceseve të digjitalizimit. "Implementimi i platformave të reja elektronike ka thjeshtuar ndjeshëm procedurat për dorëzimin e deklaratave tatimore dhe pagesave, të cilat që nga lansimi i EDI janë: 25.1 milionë E-deklarime, me gjithsej 164 293 tatimpagues të regjistruar në platformë. Kjo ka rezultuar me një rritje të efikasitetit dhe transparencës, duke bërë të mundur që bizneset t'i përbushin obligimet e tyre në mënyrë më të lehtë dhe më të shpejtë", ka thënë Murtezaj.

Ai ka shtuar se ATK-ja ka forcuar bashkëpunimin me institucionet e tjera publike dhe organizatat ndërkombëtare, duke krijuar partneritete që kanë për qëllim luftimin e evazionit fiskal dhe përmirësimin e administrimit tatimor.





# Familja Trump: kush ngrihet, kush zbret dhe ku është Melania?

Nga Lauren FEDOR,  
*Financial Times*

Kur Donald Trump pranoi për herë të parë kandidimin nga partia e tij për president në Konventën Kombëtare Republikane në vitin 2016, gruaja e tij, Melania, mbajti një fjalim në mbështetje të burrit të saj.

Katër vjet më vonë në mes të pandemisë së Covid-it, ajo bëri të njëjtën gjë, me fjalimin që e mbajti në Kopshtin e Trëndafilave të Shtëpisë së Bardhë.

Por këtë javë, teksa burri i saj përgatitet të pranojë kandidimin e Partisë Republikane për president për herë të tretë në konventën e partisë në Milwaukee, mungesa e saj ka rënë dukshëm në sy.

Profilin e ulët i Melania është pjesë e një ndryshimi të dukshëm brenda familjes së ish-presidentit që tashmë ka filluar të shfaqet në publik në konventën republikane. Gjithashtu, në festime mungojnë vajza e tij Ivanka dhe bashkëshorti i saj Jared Kushner, të cilët ishin ndihmës kryesorë në Shtëpinë e Bardhë të Trump-it. Nga ana tjetër, djali i tij më i madh Donald Jr, i cili është popullor në mesin e bazës populiste të babait të tij, ka qenë i kudondodhur në Milwaukee dhe do të flasë para kandidatit për

vendin e tij."

Si njerka e saj, edhe Ivanka pritet të dalë në kongres. Por ajo nuk është planifikuar të flasë dhe mbetet e paqartë nëse ajo apo Kushneri, i cili ka kaluar katër vitet e fundit duke u përqendruar në firmën e tij të investimeve, e cila mori një injeksion prej 2 miliardë dollarësh nga fondi i pasurisë sovraane saudite vetëm gjashtë muaj pasi Trump u largua nga Shtëpia e Bardhë, do të kërkojë një rol më të madh në fushatë, ose në një administratë të dytë Trump.

"Këtë herë, unë po zgjedh t'u jap përparesi fëmijëve të mi të vegjël dhe jetës private që po krijojmë si familje," tha Ivanka në një deklaratë pasi babai i saj njoftoi kandidimin e tij të tretë për në Shtëpinë e Bardhë. "Unë do ta mbështes gjithmonë babanë tim, por në vazhdim do ta bëj këtë jashtë arenës politike."

Kate Andersen Brower, një autore e disa librave për Shtëpinë e Bardhë, duke përfshirë First Women, tha se ishte "shumë e pazakontë" që bashkëshortja e një kandidati të mos fliste në një konventë, por Melania, e cila u akuzua se kopjoi Michelle Obamën në fjalimin e saj në konventën e vitit 2016, "ndoshta e sheh këtë si një situatë ku ka më shumë për të humbur sesa për të fituar".



dhe do të vazhdojë ta bëjë këtë," tha Mick Mulvaney, i cili ishte ushtrues detyre i shefit të kabinetit të Shtëpisë së Bardhë të Trump-it nga vitin 2019 deri në vitin 2020. "Mund të jenë anëtarë të ndryshëm të familjes në mandatin e dytë... por fëmijët e tij do të jenë gjithmonë këshilltarët e tij

"globalistët", ishte e vështirë të mos vërehej një imazh shumë i ndryshëm rreth familjes së parë në lozhën VIP: ish-personaliteti i Fox News dhe provokatori i djathtë Tucker Carlson ishte ulur gjithashtu atje, bashkë me aleatët besnikë të kongresit, si kongresmeni nga

çdo ditë, sipas një personi që e njeh marrëdhënien e tyre. Donald Jr dhe e fejuara e tij, Guilfoyle, kanë luajtur gjithashtu një rol aktiv në mbledhjen e fondeve për fushatën. Brower tha se mungesa e Ivankës dhe Melanias nga linjat e frontit në Milwaukee ishte një shenjë e pasojave që kanë pasur dy anëtarët e familjes nga presidenca e parë e Trump-it.

"Ka shumë vraga për gratë Trump," tha Brower. "Ivanka u kritikua nga shumë demokratë, të cilët mendonin se ajo do të ishte dikush që mund ta zbuste babanë e saj në Shtëpinë e Bardhë, por nuk mundi. Ose nuk donte, ose nuk mundi." Pavarësisht nga pasojat në familjen e tij, Mulvaney thotë se ai pret që një administratë e dytë e Trump-it të vazhdojë praktikën e tij të pazakontë të vendosjes së anëtarëve të familjes në politikën dhe pozicionet kryesore politike.

"Kandidati presidencial gjithmonë duhet të vendosë vullën e tij në partinë kombëtare," tha Mulvaney. "Kushdo që habitet nga vendosja e anëtarëve të familjes së tij në poste kyçe nga Donald Trump-i, nuk e njeh Donald Trump-in".

"Ndonjëherë, të vetmëve njerëz të cilëve mund t'u besosh janë familja," i tha Lara Trump The Washington Post në një intervistë të fundit. "Për [Donald Trump-in], ka qenë pikërisht kështu, për fat të keq, madje shpeshherë."



zëvendëspresident JD Vance. Të dy dihet se janë miq të ngushtë dhe të besuar.

Zyrtarët e fushatës së Trump-it kanë këmbëngulur se ish-zonja e parë, e cila është larguar nga publiku që kur burri i saj u largua nga Shtëpia e Bardhë, do të paraqitet në konventë më vonë gjatë javës. Ajo gjithashtu bëri një deklaratë të rrallë publike në fundjavë pas atentatit të mbetur në tentativë ndaj bashkëshortit të saj, duke bërë thirrje për unitet kombëtar dhe shërim.

Por ajo nuk do të flasë në skenë dhe të martën mbrëma, ishte një e sapoardhur relativisht e re në panteonin trumpian, nusja e presidentit, Lara Trump, e cila mbajti fjalimin kryesor në vendin e rezervuar historikisht për gruan e kandidatit për president që ka për qëllim të humanizojë kandidatin.

"Kur shoh Donald Trump-in, shoh një baba të mrekullueshëm, vjehrrin tim dhe gjyshin e dy fëmijëve të mi", tha Lara në fjalimin e saj. "Ky është një njeri që ka sakrifikuar për familjen e tij dhe një njeri që ka sakrifikuar vërtet për

"Ata kishin nevojë dëshpërimisht për një përfaqësuese grua nga familja Trump për ta zënë atë rol", shtoi Brower. "Lara mund ta mbushë atë boshllëk."

Ishte si një moment debutues për Larën, 41-vjeçarja ish-producente e televizioneve tabloide, e cila është e martuar me Eric Trump-in dhe në fillim të këtij viti u bë bashkëkryetare e Komitetit Kombëtar Republikan me kërkesë të vjehrrit të saj.

"Donald Trump është mbështetur gjithmonë shumë në familjen e tij


të lartë."


Ndryshimi delikat brenda familjes u shfaq gjatë natës së parë të kongresit, kur ish-presidenti bëri një paraqitje surprizë në arenë dhe u ul pranë Donald Jr dhe Eric-ut në një lozhë VIP. Ata ishin të rrethuar nga partneret e tyre, Kimberly Guilfoyle dhe Lara Trump, si dhe motra e tyre më e vogël, Tiffany Trump dhe bashkëshorti i saj, Michael Boulos. Nëse Ivanka dhe Jared-i ishin përfaqësues të asaj që disa në botën e Trump-it i quanin me tallje

Florida, Byron Donalds dhe kryetari i Dhomës së Përfaqësuesve, Mike Johnson.

Mulvaney pranoi se Ivanka dhe Jared-i përfaqësojnë elementë më "centristë" të partisë republikane, sesa fraksionet e krahut të djathtë më populistë të mishëruar nga Donald Jr dhe Vance.

Madje, asgjë nuk simbolizon epërsinë e Donald Jr më shumë sesa përzgjedhja e Vance-it. Të dy ishin miq të ngushtë dhe flasin ose shkëmbejnë mesazhe pothuajse





Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

## Ranglista e re e FIFA-s, Kosova bie për një pozitë, Shqipëria nuk lëviz vendi

**PRISHTINË, 18 KORRIK** - FIFA e ka publikuar të enjten renditjen e re të kombëtareve pak ditë pas përfundimit të Kampionatit Evropian "Gjermania 2024". Në këtë ranglistë, Kombëtarja e Kosovës ka pësuar rënie për një pozitë, ndërsa tash e shoh veten në vendin e 106 me 1203.16 pikë përpara Guatemalës dhe prapa Madagaskarit. Dardanët ishin mposhtur nga Norvegjia me rezultat të thellë 0:3 në miqësoren e qershorit, e

fundit para Ligës së Kombeve, e cila do të nisë në muajin shtator. Ndërsa Kombëtarja e Shqipërisë, e cila ka marrë pjesë në "Euro 2024", nuk ka lëvizur nga vendi: është e 66-ta me 1375.49 pikë, përpara Burkina Fasos dhe prapa Kepit të Gjellbër. Kuqezinjtë janë mposhtur nga Spanja e nga Italia, ndërsa kanë barazuar me Kroacinë në fazën e grupeve të Evropianit. Renditjes së përgjithshme

vazhdon t'i prijë fituesja e freskët e "Copa Americas", Argjentina, e ndjekur nga Franca. Kurse kampionia e re e Evropës, Spanja, ka përparuar për pesë pozita duke përfunduar në vendin e tretë, e ndjekur nga nënkampionia evropiane, Anglia, e cila ka përparuar për një pozitë. Rënie ka pasur Brazili, i cili ka dëshpëruar në "Copa America" dhe tash e shoh veten në vendin e pestë.



## Shumë yje shkëlqyen në "Euro 2024", kush pritet të ndryshojë ambient në verë?

**PRISHTINË, 18 KORRIK** - Shumë lojtarë kanë tërhequr vëmendjen në "Euro 2024", por a do të ndryshojë ambient ndonjëri prej tyre këtë verë? Ishte një mundësi e përsosur për t'u vendosur në treg me afatin e transferimeve të hapur deri më 30 gusht në shumicën e ligave kryesore të Evropës. Kjo ka ndodhur në të kaluarën me paraqitjet mbresëlënëse të Cody Gakpo për Holandën që i sollën një transferim te Liverpooli, ndërsa Enzo Fernandes u bashkua me Chelsea në një transferim prej 107 milionë funtash nga Benfica pasi u shpall lojtari i ri më i mirë i turneut në Kupën e Botës 2022. Pra, cilët yje nga Gjermania janë lidhur me një lëvizje? **Florian Wirtz (Gjermani)** - Mesfushori i Bayer Leverkusen Wirtz, 21 vjeç, filloi çdo ndeshje grupore ndërsa Gjermania arriti në çerekfinale në tokën e saj. Ai është një nga talentët më të ndritur të vendit dhe ka lënë përshtypje për Leverkusenin në Bundesliga. Me një kontratë që zgjat deri më 2027, Leverkuseni nuk ka ndër mend ta shesë por, natyrisht, Wirtz ka tërhequr interes nga klubet kryesore. Real Madridi dhe Barcelona raportohet se janë të interesuar, por babai dhe agjenti i Wirtz kanë minimizuar thashethemet se ai mund të lëvizë këtë verë.

**Marc Guehi (Angli)** - Duke zëvendësuar Harry Maguire të dëmtuar, mbrojtësi i Crystal Palace Marc Guehi, 24 vjeç, ka pasur një turne të fortë për Anglinë. Ai është bërë partneri i preferuar i Gareth Southgate për qendërmbrojtësin e rregullt John Stones pas një sezoni të shkëlqyer në Premierë Ligë. Palace nënshkroi Guehi me një marrëveshje pesëvjeçare nga Chelsea në 2021, por raportet thonë se klubet kryesore angleze po e ndjekin atë. Arsenali dhe Manchester Unitedi janë ndër ata që janë lidhur, kështu që Palace mund të ketë një betejë për ta mbajtur atë. **Xavi Simons (Holandë)** - Mesfushori i Paris St-Germain, Xavi Simons, 21 vjeç, u kritikua nga mediet holandeze gjatë gjithë "Euro 2024", por ai ende e ndihmoi të arrijë gjysmëfinale. Ai tregoi aftësitë e tij kur ishte e nevojshme, duke shënuar një gol të shkëlqyer kundër Anglisë dhe që atëherë thashethemet kanë qenë të pranishme për një largim të mundshëm nga PSG. Manchester Unitedi, Arsenali dhe Newcastle janë ndër klubet e Premierë Ligës që janë lidhur me një transferim potencial. Simonsi kaloi sezonin e kaluar në huazim te RB Leipzig dhe ka raportime se PSG mund të jetë i hapur për një huazim tjetër, por vetëm me një



detyrim për të blerë. **Nico Williams (Spanjë)** - Anësori i talentuar i Athletic Bilbao Williams, 22 vjeç, ishte një nga lojtarët më të spikatur të turneut. Ai shkëlqeu në fitoren 1-0 të Spanjës ndaj Italisë, shënoi një gol të fuqishëm në fitoren e tyre 4-1 ndaj Gjeorgjisë dhe realizoi një gol të shkëlqyer në finalen kundër Anglisë. Ai ka qenë i lidhur fort me një lëvizje te Barcelona gjatë gjithë verës, me spanjollët që raportohet se e kanë bërë atë objektivin e tyre kryesor. **Joshua Kimmich (Gjermani)** - Mbrojtësi i Bayern Munich Kimmich, 29 vjeç, ka qenë një pjesë e rëndësishme në ekipin e Gjermanisë për një kohë dhe ai filloi çdo ndeshje ndërsa ata arritën në çerekfinale. Pas nëntë vjetësh me Bayernin, a mund të lëvizë më në fund këtë verë?

Liverpooli, Arsenali dhe Manchester City janë ndër ekipet që janë lidhur me Kimmich, i cili ka një vit të mbetur në kontratën e tij. Raportet thonë se ai mund të jetë i disponueshëm për deri në 40 milionë funte. **Riccardo Calafiori (Itali)** - Mbrojtësi i Bolognas, Calafiori, është lidhur shumë me një lëvizje tek Arsenali këtë verë. 22-vjeçari raportohet se ka mbajtur bisedime me "Topçinjtë" pasi mbrojtja e titullit të Italisë në Evropian përfundoi para kohe me një eliminim në 1/8-tën. Calafiori më parë ka luajtur për FC Basel dhe Roma, si dhe një periudhë huazimi te Genoa. **Georgiy Sudakov (Ukrainë)** - Mesfushori i Shakhtar Donetsk Sudakov, 21 vjeç, ka kaluar të gjithë karrierën e tij në Ukrainë,

por mund të largohet këtë verë. Chelsea thuhet se është duke e ndjekur dhe mund të detyrohet të paguajë deri në 65 milionë funte për ukrainasin. Ai filloi të gjitha tri ndeshjet e grupit të Ukrainës, por nuk mundi t'i ndihmojë ata të kalonin në fazat e eliminimit. Arsenali, Manchester City dhe Liverpooli gjithashtu janë lidhur me lojtarin. **Dani Olmo (Spanjë)** - Duke përfunduar "Euro 2024" me tre gola dhe dy asistime, Olmo ishte një tjetër yll spanjoll. 26-vjeçari nga RB Leipzig nuk mundi të futej në formacionin titullar për dy ndeshjet e para, por shkëlqeu në fazat e eliminimit. Disa klube të Premierë Ligës janë lidhur, përfshirë Manchester Cityn, Manchester Unitedin, Chelsea dhe Liverpoolin. Raportohet se ai ka një klauzolë lirim prej 50 milionë funtash që skadon më 20 korrik. **Khvicha Kvaratskhelia (Gjeorgji)** - Sulmuesi gjeorgjian Kvaratskhelia, 23 vjeç, ishte një kërcënim në "Euro 2024" dhe thuhet se po ndiqet nga PSG. Napoli e vlerëson atë në 100 milionë euro, që mund të jetë më shumë sesa PSG-ja, është e gatshme të paguajë. Liverpooli, gjithashtu, është lidhur, por trajneri i Napolit, Antonio Conte, ka hedhur poshtë thashethemet se ai mund të largohet nga klubi italian këtë verë.

## Southamptoni vazhdon të interesohet për Brojën



**LONDËR, 18 KORRIK** - Southamptoni mbetet i interesuar për sulmuesin shqiptar të Chelseat, Armando Broja, i cili është i tepërt në "Stamford Bridge", raporton "Sky Sports". Broja ka pasur një huazim zhgënjyes te Fulhami në gjysmën e dytë të sezonit të kaluar, duke u

paraqitur vetëm tetë herë dhe duke dështuar të shënonte për "Cottagers". Pavarësisht prej përvojës zhgënjyese, shqiptari ka tërhequr interesin e disa klubeve këtë verë, përfshirë Evertonin dhe Milanin. Sidoqoftë, "Sky Sports" ka sugjeruar që Southamptoni

aktualisht është skuadra që shfaq interesin më të madh për ta rimarrë 22-vjeçarin, i cili ka luajtur një vit i huazuar në sezonin 2021/22 te kjo skuadër. Drejtuesit e Southamptonit duan të blejnë një sulmues për ta shtuar konkurrencën ndaj dyshes Adam Armstrong-Ross

Stewart pas skadimit të kontratës së Che Adams. Broja konsiderohet një opsion i mundshëm me Chelsea që supozohet se është i gatshëm të hyjë në bisedime për këtë lëvizje. Broja, i rritur në akademinë e Chelseat, është huazuar në tri raste nga blutë e Londrës.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Trepça Shoqëri Aksionare  
Trepça Deonitarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



Duke u bazuar ne Rregulloren për dhënie me qera te pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokoli 119 date 11.01.2021, Zyra e shitjes me datën 18.07.2024 bënë shpallje publike për dhënie e pronës së paluajtshme me qera.

## Shpallje Publike T-24-11

Autoriteti Kontraktues (AK): Trepça Sh.A.

Adresa e AK: Parku Industrial  
MITROVICË  
40000

Personi Kontaktues: Behxhet Nimani  
E-mail: behxhetnimani@hotmail.com  
Telefoni: +381 28 538 050  
Faks: +381 28 539 202

### Shpallja Publike

#### Qëllimi i ofertës:

- Dhënie me qera e objekteve Objekti i menzës së Metalirgjisë së Zinkut- Restorani dhe Objekti -Magazina e Makinerisë (Depoja përcjellëse e puntorisë) Njësinë Biznesore Metalurgjia e Zinkut
- Sipërfaqja dhe çmimi fillestar

#### 1. Njësia Biznesore Metalurgjia e Zinkut

##### 1. Çmimi fillestar

Njësia Biznesore: Metalurgjia e Zinkut						
Data:	Objekti	Sipërfaqja e mbuluar(m2)	Çmimi neto (€)	TVSH (€)	Çmimi me TVSH (€)	Totali i qerasë (€)
18.07.2024						
1	Objekti i Menzës (Restorant) i MZ	525.00	1.10	0.20	1.30	681.45
2	Objekti - Magazina (Depo përcjellëse e puntorisë)	80.00	1.10	0.20	1.30	103.84

Kriteret e Dhënies: Dhënia e kontratës do të bazohet në çmimin më të lartë

Data e shpalljes: 18.07.2024

Sqarimi: deri me 07.08.2024

Kërkesa për pjesëmarrje: Data(t) për kërkesës deri: 07.08.2024  
Bëhet në e-Mail: poshtë shënuar ose në Zyrën e shitjes dhe qirasë.

Dorëzimi i ofertave: Dorëzimi i ofertave bëhet ne formë fizike (zarf te mbyllur) (Originali dhe Kopja)

Afati i fundit i dorëzimit: 07.08.2024 në 11:00

Vendi i dorëzimit: Zyra e shitjes dhe qirasë të Trepça Sh.A.  
Parku Industrial, Mitrovicë (PIM)

#### Kërkesat minimale të kualifikimit:

- Kopja e certifikatës së regjistrimit të biznesit të entitetit.
- Kopje të certifikatës së regjistrimit për TVSH ( vetëm për ofertuesit vendor)
- Vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore se operatori ekonomik në fjalë nuk është në vonës në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të njoftimit për kontratë.
- Nuk ka obligime ndaj Trepçës të pa paguara.

#### Shënime shtesë:

**Çmimi i ofertës:** Çmimi i ofruar nga O.E të interesuar do të jetë më i madh apo i barabartë me çmimin e parashikuar nga Autoriteti Kontraktues - Trepça Sh.A.

**Obligimet:** Ofertuesi fitues do të bartë të gjitha obligimet e investimeve si dhe të gjitha shpenzimet administrative, komunale dhe shpenzimet tjera të cilat dalin mbas lidhjes së kontratës.

**Oferta:** Duhet të përfshijë çmimin për m<sup>2</sup> duke përfshirë TVSH-në dhe Çmimin total shih Aneks1.

**Pagesa:** Të gjitha pagesat do të bëhen në EURO, pa ndalesë, kundërkërkesë ose çfarëdo zbritje në llogarinë bankare të Trepça Sh.A.

**Operatorët ekonomik:** që nuk i paraqesin të gjitha të dhënat për formimin e çmimit Aneks 1 dhe deklarimi Aneks 2 Ofertat e tyre nuk do të shqyrtohet.

### Aneksi 1

### OFERTA

Emri i OE:	
Loti	
Kodi (T)	

Llogaritja e qerasë për sipërfaqen e mbuluar		
a	Sipërfaqe e mbuluar m2	
b	Çmimi për meter katrorë m2 në (€) pa TVSH	
c=b*18%	TVSH e çmimit për meter katrorë m2 në (€)	
d=b+c	Çmimi për meter katrorë m2 në (€) me TVSH	
e=a*d	Gjithsejt qeraja me TVSH në (€)	
e=c+d	Për pagesë në (€)	

Tatimi në qira prej 9% gjithashtu bije në barrë të qiramarrësit dhe pagesën e saj e bënë qiramarrësi

Nëshkrimi:	
Data:	
Vula:	

### Aneksi 2 DEKLARATA NËN BETIM

Unë, i poshtë nëshkruari, duke përfaqësuar: *operatorin ekonomik që paraqitet* deklaroj nën betim se jam i përshtatshëm në përputhje me Rregulloren për dhënie me qira te pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokoli 119 date 11.01.2021.

Unë vërtetoj se i kam lexuar kërkesat e përshtatshmërisë në rregulloren dhe siguroj se jam i përshtatshëm të marrë pjesë.

Unë pranoj mundësinë e sanksionimeve penale dhe civile, gjobave dhe dënimeve, nëse unë për shkak të pakujdesisë dorëzoj çfarëdo dokumenti ose deklarata që përmban informata përmbajtësish të gabueshme ose mashtruese.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri i OE:	
Adresa e plotë:	
I përfaqësuar nga:	
Emri:	
Pozita:	
E-mail:	
Tel:	
Nëshkrimi:	
Data:	
Vula:	

### Aneks 3. Pjesëmarrja

Pjesëmarrja - Marrja e Aplikacionit mund të behet deri me datën 07.07.2024 deri në orën 11.00 për mes e-mail ose në Zyren e Shitjes.

### Aneks 4. Përshkrimi i Aseteve

Përshkrimi i aseteve të shënuara më poshtë shërbejnë vetëm për qëllime të informimit dhe Autoriteti Kontraktues nuk ofron garanci të saktësisë së përshkrimit. Këto asete jepen në kushte të gjendjes aktuale "ashtu siç janë dhe ku janë" dhe autoriteti kontraktues nuk ofron Garancion në lidhje me gjendjen e aseteve. Tenderuesi bartë rrezikshmërinë e plotë për gjendjen e aseteve.

Objekti është i ndarë në lote,

**Trepça Sh.A.** përmes këtij njoftimi përcakton kushtet dhe termet dhënës me qiratë objekteve dhe hapësirave sipas tenderit me metodën e çmimit ekonomikisht më të lartë, bazuar në parametrat e poshtëshënuar që përcaktojnë formimin e çmimit ekonomikisht më të lartë.

### DHËNIE ME QIRA E OBJEKTIT

Oferta duhet të jepet për m<sup>2</sup> dhe llogaritja përfundimtare në faturim

**NJOFTIM**

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Barber Shop Shpëtimi” SH.P.K. me seli Rruga. “Arsim Muzaqi” nr. 11 - Vushtrri, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 811464990 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

**OBAVESTENJE**

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Barber Shop Shpëtimi” SH.P.K. D.O.O. od ulica “Arsim Muzaqi” nr. 11 - Vushtrri, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811464990 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

**ANNOUNCEMENT**

We inform all customers that the limited liability “Barber Shop Shpëtimi” SH.P.K L.L.C. with headquarters Str. “Arsim Muzaqi” nr. 11 - Vushtrri, has come to the decision to quit its business: 811464990 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS  
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Oda e Mjekëve të Kosovës – Kosovo Doctors Chamber – Lekarska Komora Kosova

**FTESË PËR OFERTË**

**Lloji i Kontratës:**  Furnizim  Shërbime  Punë

Nr. i Prokurimit 04-24

Oda e Mjekëve të Kosovës është organizatë e pavarur profesionale e mjekëve që ushtron veprimtari profesionale mjekësore në Republikën e Kosovës.

OMK anëtareve të saj, i siguron standarde të larta të kodit të etikës dhe deontologjisë mjekësore, promovon dhe mbrojnë veprimtarinë e profesionistëve shëndetësorë në institucionet shëndetësore publike, private si dhe publiko-private, siguron edukimin e vazhdueshëm profesional me qëllim të ngritjes së performancës shëndetësore dhe ofrimit më cilësor të shërbimeve shëndetësore dhe shërbimeve tjera që kanë të bëjnë me kujdesin shëndetësor.

Oda e Mjekëve të Kosovës fton të gjitha kompanitë e interesuara që të paraqesin kërkesën e tyre për dosje të tenderit në adresën **Instituti A, Kati 2, QKUK, 10 000 Prishtinë**, apo përmes emailit: **info@omk-rks.org**, me titullin:

**Dosja për: Kontratë për hapsirën e mbajtjes të simpoziumit ZEVA**

Në pajtim me Nenin 9, paragrafin 1 të Rregullores për Procedurat e Prokurimit në OMK:

Afati për parashtrimin e ofertave është në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e publikimit, për Kontratën me vlerë të madhe (që tejkalojnë shumën prej 10,000.00 €).

Afati për parashtrimin e ofertave është në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) ditëve nga dita e publikimit, për Kontratën me vlerë të mesme (**vlera e të cilave është deri në 10,000.00 €**).

Njoftimin për kontratë mund ta shkarkoni në uebin e Odës: <https://omk-rks.org/>

**Afatet Kohore.**

Afati i fundit për tërheqje të dosjes së Tenderit është: **23.07.2024 ora 14:00.**

Afati i fundit për aplikim në Tender është: **25.07.2024 ora 12:00.**

Flapja e ofertave bëhet me datën: **25.07.2024 ora 13:00.**

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



[www.facebook.com/gjeipuneshpejte](http://www.facebook.com/gjeipuneshpejte)

**RESTAURANT**

# SWISS

## TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

- Arb Aliaj shpall te pavlefshme certifikatën e maturës pikat e testit Q.K. “11 Marsi” Prizren.

- Fatlind Krasniqi shpall te pavlefshme 3 dëftesa dhe diplomën Q.K. “11 Marsi” Prizren.

- Tuba Capo shpall te pavlefshme dëftesat, diplomën, certifikatën Q.K “11 Marsi” Prizren.

- Kybra Capo shpall te pavlefshme dëftesat, diplomën, certifikatën Q.K. “11 Marsi” Prizren.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

**MEKA**  
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992







## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

